



**VENDIM**

**Nr. 75, Datë 07.06.2016**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË  
INVESTIMEVE PËR VITIN 2016 PËR KESH SH.A**

Ne mbështetje të nenit 16; nenit 109 pika 5; nenit 110, pika 2 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të VKM-se Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; gjithashtu dhe “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr. 62, datë 15.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “KESH”sha, të përgatitur nga Grupi i punës;

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “KESH”sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**